



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në ankesën e

AC-I-22-0488

Paditësja/Ankuesja

D G nga Prizreni - e përfaqësuar nga Projekti për Ndihmë Juridike, K L, Graqanicë.

kundër

E paditura

NSH "Printeks" (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, Shkelzen Sylaj, Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV.-13-1663 të datës 19 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 25 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-IV.-13-1663 i datës 19 korrik 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 04 shtator 2013, paditësja parashtroi ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.PRZ036-0553 të datës 13 gusht 2013, me të cilin i ishte refuzuar si e pa bazuar kërkesa për kompensimin për paga të pa paguara në shumë prej 7,760.00 euro, nga NSH."Printeks"(në likuidim). Në mbështetje të ankesës dorëzoi kopjen e vendimit të kundërshtuar. Në vendimin e kundërshtuar Autoriteti i Likuidimit kishte arsyetuar se kërkesa është parashtruar para fillimit të procedurës së likuidimit.

Më 21 shkurt 2014, gjykata lëshoi urdhër me të cilin kërkoi nga paditësja që ndër të tjera të dorëzojë autorizimin për përfaqësim.

Më 12 janar 2018, paditësja dorëzoi autorizimin për përfaqësim.

Më 22 qershor 2018, e paditura AKP ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar drejtë. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Më 12 korrik 2018, paditësja parashtroi përgjigje në mbrojtjen e të paditurës.

Më 23 gusht 2018, përgjigja e paditëses i është dorëzuar të paditurës, e njëjta nuk parashtroi kundërpërgjigje .

Me 19 korrik 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktvendimin C-IV-13-01663, e ka hedhur poshtë si të pa pranueshme ankesën kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRZ036-0553 të datës 13 gusht 2013.

Në arsyetim të këtij aktvendimi thuhet se duke u bazuar në nenin 74.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se: Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i autoritetit të likuidimit mund të kundërshtojë vendimin e tillë duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve par pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në

pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë brenda 30 ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.

Nenet 33 dhe 35, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisja e procedurave në Dhomën e Posaçme. Neni 35.2 më tej përcakton se çfarë duhet të përmbaje një kërkesë apo ankesë.

Neni 36.2.2.4, i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që: kërkesa/ankesa janë parashtruar brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj. Një rregullim të njëjtë ishte paraparë edhe më shtojcën e ligjit NR.04/L033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht në nenin 25,27,28 të njëjtit, si ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të ankesës.

Neni 46, pika C të Ligjit mbi procedurën administrative (si ligj në fuqi në kohën e parashtrimit të kërkesës) parasheh që: Verifikimi paraprak i disa çështjeve të përpara fillimit të procedimit administrativ Përveç verifikimit të kompetencës, e cila bëhet nga organi i administratës publike sipas procedurës të parashikuar në neni 12 të këtij Ligji, menjëherë pas mbërritjes së kërkesës së palës së interesuar për fillimin e procedimit administrativ, organi administrativ bën gjithashtu edhe verifikimet e mëposhtme "c) nëse afatet e parashikuar nga ligji për dorëzimin e kërkesës janë respektuar.

Andaj në kuptim të këtyre dispozitave vjen në përfundim se kërkesa pranë AL-së duhet të dorëzohet brenda afatit të paraparë në atë procedurë. Në këtë mënyrë, dorëzimi i një kërkesë të afatshme nga ankuesi është një kriter i provueshmërisë së ankesës, përkatësisht mosdorëzimi i kërkesës pranë AL në afat, e bën ankesën e tij të papranueshme.

Shkalla e parë në arsyetim ka konstatuar se paditësja nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKP-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH" Printeks" kishte

hyrë në proces të likuidimit. AKP kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së më 20 korrik 2006 edhe më 26 korrik-2006, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH "Printeks"(në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri më datën 26 shtator 2006.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja kërkesën e saj e kishte parashtruar më datë 02 shkurt 2006. Nga kjo konstatohet se paditësja kërkesën nuk e kishte parashtruar brenda aftit kohorë të paraparë nga AL. Paditësja në ankesë nuk ka sjellë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte faktin e mos ushtrimit të ankesës brenda aftit të paraparë nga AL. Njoftimi për fillimin e likuidimit dhe paraqitjen e kërkesave eventuale kreditorë ndaj NSH "Printeks", është bërë nga e paditura në mënyrë publike dhe atë në shpallje është paraparë afati dhe adresa, se ku duhet të dorëzohen kërkesat ndaj NSH-së. Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0129, AC-I-20-0210) për hedhjen poshtë të ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditorë janë parashtruar para aftit për paraqitjen e tyre në AL.

Me 17 gusht 2022, nëpërmjet postës përfaqësuesja e paditëses e kishte dorëzuar në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-1663 dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të dhe lëndën dhe ta kthejë për rigjykim ose ta ndryshojë aktvendimin e shkallës së parë, ta anulojë vendimin PRZO36-0553 të datës 13 gusht 2013, të AKP-së dhe të vendos në mënyrë meritorë sipas kërkesë padisë të paditëses.

Në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit, ka theksuar se në arsyetimin e aktvendimit thuhet se padia e paditësit hedhet si e papranueshme sipas asaj që thuhet në gjykatën e shkallës së parë paditësi nuk ka paraqitur kërkesë në AKP-së brenda afatit të caktuar. Po ashtu në ankesë ka theksuar se gjykata ka vendosur në dispozitiv duke zbatuar dispozitat e nenit 35 paragrafi 2 pika 2.4 të aneksit të Ligjit për AKP-në. nr. 04/L-034 i cili përcakton: "Nëse kreditori i supozuar ose titullari i interesit ofron një arsyetim bindës për paraqitjen e vonuar, autoriteti likuidues, sipas gjykimit të tij, mund të pranojë dëshminë e kërkesës ose të interesit të paraqitur pas afatit për raportim. padia, nëse dëshmia e kërkesëpadisë ose e kamatës jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas

skadimit të afatit për paraqitjen e padisë”, duke konsideruar se ankesa e paditëses ka qenë e parakohshme, e paraqitur pas afatit për paraqitjen e kërkesave. Po ashtu zbatimi i gabuar dhe jo i plotë i dispozitave të ligjit për AKP-së nr. 04/L-034, reflektohet në faktin se gjykata nuk e ka marrë parasysh faktin se i padituri nuk ka vepruar në pajtim me nenin 7 par. 4 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034, i cili përcakton se Autoriteti i Likuidimit [...] i dërgon një kopje të njoftimit të likuidimit çdo personi që ka njoftuar më parë Agjencinë ose Gjykatën me shkrim për një kërkesë nga -ndërmarrje ose një interes i supozuar....” Duke pasur parasysh se paditësja në mënyrë të padiskutueshme ka ushtruar kërkesë për paga të papaguara në adresë. Autoriteti kompetent përmes shtyllës së Zyrës së BE-së në Beograd në vitin 2006, pas pranimit të njoftimi nga zyra në Beograd, me të cilin paditësja ka përmbushur kërkesat formale për paraqitjen e njoftimit të kërkesëpadisë, dhe për shkak të dështimit -lëshimit të paditurës-, paditësja duhet të mos pësojë asnjë pasojë ligjore. Po ashtu e paditura AKP -ja me asnjë veprim nuk e ka njoftuar paditësen edhe pse nuk ka pasur pengesa, madje e paditura në praktikë i njofton personalisht paditësit, gjë që nuk e ka bërë me paditësen, se procedura e likuidimit të NSH-së ka filluar, edhe pse AKP paraprakisht ka qenë e informuar për padinë e paditëses dhe e paditura sipas dispozitave të lartpërmendura të Ligjit për AKP është dashur që personalisht ta informojë paditësen për fillimin e likuidimit, gjë që nuk e ka bërë dhe paraqet një lëshim të paditurës. Paditësja në ankesën e parashtuar konsideron se , aktvendimi i AKP-së PRZ036-0553 i datës 13.08.2013 bazohet në gjendjen faktike jo të saktë dhe jo të plotë si dhe në zbatimin e gabuar dhe jo të plotë të së drejtës materiale.

Me 21 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtuar si dhe në Aktvendimin me nr.C-IV.-13-1663 të DHPGJS, pranë shkallës së I-re Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtuar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare i parashton Kolegjit të ankesave që t’i referohet Mbrojtjes së aktvendimit përkatës.

AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me datë 02 shkurt 2006, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH.- DP "Printeks"-Prizren (në likuidim), një kërkesë për kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 7,760.00 euro, mirëpo AL e kishte refuzuar si të pavlefshëm kërkesën e me arsyetim sa jo ishte parashtruar para afatit të dorëzimit të kërkesave që ishte deri më datën 26 shtator 2006.

Kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit paditësja e dorëzoi në Shkallë të I-rë të DHPGJS një ankesë dhe kërkoj nga e jejtja që ta aprovojë kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 7,760.00 euro nga Ndërmarrjes Shoqërore "Printeks"-Prizren (në likuidim).

Me 19 korrik 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së me Aktvendimin C-IV-13-1663, e ka hedhur poshtë si të pa pranueshme ankesën e paditëse të paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRZ036-0553 të datës 13 gusht 2013, me arsyetimin se paditësi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKP-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH" Printeks" kishte hyrë në proces

të likuidimit. AKP kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së më 20 korrik 2006 edhe më 26 korrik-2006, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH "Printeks"(në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri më datën 26 shtator 2006. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësja kërkesën e saj e kishte parashtruar më datë 02 shkurt 2006 dhe nga kjo konstatohet se paditësja kërkesën e saj nuk e kishte parashtruar brenda aftit kohorë të paraparë nga AL. Tutja Shkalla e I-rë kishte arsyetuar se njoftimi për fillimin e likuidimit dhe paraqitjen e kërkesave eventuale kreditorë ndaj NSH "Printeks", është bërë nga e paditura në mënyrë publike dhe atë në shpallje është paraparë afati dhe adresa, se ku duhet të dorëzohen kërkesat ndaj NSH-së. Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0129, AC-I-20-0210) për hedhjen poshtë të ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditorë janë parashtruar para aftit për paraqitjen e tyre në AL.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se paditësja kërkesën e saj të Autoriteti i Likuidimit nuk e kishte parashtruar me kohë ashtu siç ishte parapara afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKP-ja, e që ishte data e fundit 26 shtator 2006.

Kolegji i Apelit pajtohet me konstatimin e Shkallës së I-rë e cila ka konstatuar se paditësja kishte paraqitur kërkesë jashtë afati me dt. 02 shkurt 2006, që është para datës së fillimit të procedure së likuidimit të NSH-së (4 korrik 2006).

Kolegji vëren se Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së më 20 korrik 2006 edhe më 26 korrik-2006, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH "Printeks"(në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri më datën 26 shtator 2006. Njoftimi është bërë edhe në web faqen e AKP-së.

Publikimet e si përmendura shprehin qartë se çdo person i cili beson se ai/ajo ka një kërkesë të vlefshme të dorëzuar jashtë afatit për parashtrim, do të rezultojë në humbje e se drejtës nga ana e personave në fjalë për të përfituar nga shpërndarja e te ardhurave të likuidimit, prandaj pretendimet e paditësës

se ajo është dashur të informohet personalisht nga e padatuara dhe se ajo ka paraqitur kërkesë me kohë janë të pabazuar.

Kolegji i Apelit gjithashtu vëren se Autoriteti i Likuidimit me rastin e shqyrtimit të kërkesës së paditëses, drejtë kishte aplikuar dispozitat ligjore meqë dispozita e nenit 35 par 3 e Shtojcës së Ligjit për AKP-në Nr.04/L-034, i cili i ndalon të paditurës ta pranoj një kërkesë si të afatshme nëse dëshmia e kërkesës është parashtruar më vonë se tridhjetë (30) ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesës. Po ashtu dispozita e nenit 36.2 dhe 2.1 e të njëjtit Ligj, rregullon çështjen e vlefshmërisë së kërkesave, brenda afatit të caktuar, në rastin kur kërkesa apo pretendimi është i pasafatshem sipas kufizimeve kohore. Prandaj në rastin konkret paditësja kishte parashtruar kërkesë para se NSH të hynte në Likuidim, pra para afatit të paraparë me dispozita ligjore për paraqitjen e kërkesave në AL, prandaj bazuar në këtë, AL dhe Shkalla e I-rë e DHPGJS kanë vepruar drejtë, dhe në përputhje me dispozita ligjore.

Andaj për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditëses si të pabazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksa gjyqësore

Paditësja/ankuesja, lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, konform nenit 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, meqë ankuesja është përfitues i Ndihmave Juridike Falas.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 25 korrik 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
